**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***

---

**Nr. 01/65**
**Datë: 13.09.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator 2018, nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohen procesverbalet nga mbledhjet 60, 61 dhe 62 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***

---

**Nr. 02/65**
**Datë: 13.09.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator 2018, nxjerr këtë:

# V E N D I M

**Për ndryshimin dhe plotësimin e Programit Legjislativ të vitit 2018 të Qeverisë së Republikës së Kosovës**

1. Në Programin Legjislativ të vitit 2018 të Qeverisë së Republikës së Kosovës ndryshohet afati i miratimit nga Qeveria e Republikës së Kosovës për këto Projektligje:

    1.1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-004 për Shërbimet Private të Sigurisë (MPB) - 30.11.2018;
    1.2. Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-125 për Shëndetësi (MSH) - 15.11.2018;
    1.3. Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.04/L-249 për Sigurime Shëndetësore (MSH) - 25.11.2018.

2. Ngarkohet Zyra Ligjore e Zyrës së Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 03/65**
**Datë: 13.09.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Fushën e Tregtisë.

2. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 04/65**
**Datë: 13.09.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 05/65**
**Datë: 13.09.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*


**Nr. 06/65**

**Datë: 13.09.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator 2018, nxjerr këtë:

# V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ministrinë e Mbrojtjes.

2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***

---

**Nr. 07/65**
**Datë: 13.09.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5 paragrafi 1. të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet rekomandimi i Komisionit Ndër-Ministror për Ndërmarrjet Publike për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të aseteve të NPQ "Aeroporti i Gjakovës" Sh.A. për KRU "Gjakova" Sh.A. sipas listës së bashkëngjitur.

2. NPQ "Aeroporti i Gjakovës" Sh.A. ruan të drejtën ekskluzive mbi pronësinë e aseteve.

3. NPQ "Aeroporti i Gjakovës" Sh.A. në çdo kohë mund të paraqesë kërkesë për kthimin e aseteve, të cilat do t'i nënshtrohen normave për menaxhimin e pasurive jofinanciare, të cilat brenda 30 ditëve duhet të vihen në dispozicion të së njëjtës.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

NPQ "Aeroporti Gjakovës" Sh.A dt. 02.08.2018

LISTA E MAKINERISE DHE MJETEVE TE PUNES REFERUAR KERKESES SE KRU "GJAKOVA" SH.A - listat përfshijnë vetëm paisjet që aktualisht nuk përdoren nga NPQ "Aeroporti I Gjakoves" Sh.A.

| Nr. | Marka / Lloji / Tipi i Makines | Tipi | Lloji i inventarizimit | Kategoria / Tonazhi | Vlera në EURO | Viti i Prodhimit | Pesha kg | Nr. Shasisë | Gjendja aktuale | Përshkrimi | Komenti | Ne perdorim nga AGJ | Aktualisht nuk perdoret nga AGJ | Shpjegime | Sqarimi listave |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| AUTOMJETET (të pa përfshira në kërkesën paraprake të KRU Gjakova) - por të kërkuara me email (dt. 02.08.2018) nga MZHE bazuar shpjegimeve të përgjigjes nga AGJ dt.31.07.2018 | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | IVECO EUROTECH | | M.TH 045 | Rëndë | 151,901 | | / | ZCFAITLK00 4191345* | O.K | Kamion Cistern karburanti | Kamion Cistern karburanti | | ✓ | Aktualisht nuk perdoret nga AGJ | Lista shtese që aktualisht nuk përdoren nga AGJ (makineri te papërfshira në listën paraprake meqë kërkesa e KRU "Gjakova" nuk i ka përfshi këto makineri). |
| 2 | Sirmac VAM 420 P / Zjarrfikës | VAM 420 P | M.TH 001 | Rëndë | 83,640 | / | / | ZA9VAM420 PIB05069 | Defekt | Kamion Zjarrefikes | Defekt hedhësi I ujit, 2 valvula elektro pneumatike, rrypi I kompresorit, servisimi periodik dhe 4 bateri 110 Ah. | | ✓ | Aktualisht nuk perdoret nga AGJ | |
| 3 | Sirmac VAM 420 P / Zjarrfikës | VAM 420 P | M.TH 004 | Rëndë | 83,640 | / | / | pn | Defekt | Kamion Zjarrefikes | Gjendja aktuale; mungon rrypi i kompresorit 2 cop, 1 valvul elktro pneumatike, servisimi periodik dhe 4 bateri 110 Ah. | | ✓ | Aktualisht nuk perdoret nga AGJ | |
| 4 | ASTRA BM 201 M / Cistern Uji | BM 201 FZM | M.Th 096 | Rëndë | 72,009 | / | 18000 | ZCNBM201F ZS0115715 | Defekt | Cisternë uji | Gjendja e makines kryesisht e mirë por me disa defekte ; pompa hidraulike e presionit të lartë e sistemit të ujit, vasketa e ujit të motorrit, servisimi periodik, dhe 2 baterive 110 Ah. | | ✓ | Aktualisht nuk perdoret nga AGJ | |
| 5 | Karikues Baterie | n/a | INV 108 | Lehtë | 422 | / | / | EN60335-2-29 | OK | Karikues baterie | | | ✓ | Aktualisht nuk perdoret nga AGJ | |

LISTA E MAKINERISE DHE MJETEVE TE PUNES REFERUAR KERKESES SE KRU "GJAKOVA" SH.A - listat përfshijnë vetëm paisjet që aktualisht nuk përdoren nga NPQ "Aeroporti I Gjakoves" Sh.A.

| Nr. | Marka / Lloji / Tipi I Makines | Tipi | Lloji I Inventarizimit | Kategori a / Tonazhi | Vlera në EURO | Viti I Prodhimit | Pesha kg | Nr. Shasisë | Gjendja aktuale | Përshkrimi | Komenti | Ne perdorim nga AGJ | Aktualisht nuk perdoret nga AGJ | Shpjegime | Sqarim I listave |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| AUTOMJETET (të përfshira në kërkesën paraprake të KRU Gjakova) - dhe dërguara në MZHE përmes përgjigjes nga AGJ dt.31.07.2018 | | | | | | | | | | | | | | | |
| 6 | IVECO FIAT VM 90 / Ushtarak | 40-10.2 WM | M.TH 006 | Speicale | 37,420 | 1992 | / | D4078209014 | Defekt | Automjet ushtarak | Motorri defekt problem me ndezjen, servisim periodik dhe 2 bateri 110 Ah. | | ✓ | Aktualisht nuk perdoret nga AGJ | Makineria që aktualisht nuk përdoren nga AGJ të cilat janë të përfshira në listën paraprake dorëzuar në MZHE dt. 31.07.2018 meqë kanë qenë tkërkuara nga KRU "Gjakova". |
| 7 | IVECO FIAT VM 90 / Ushtarak | 40-10.2 WM | M.TH 012 | Speicale | 37,420 | 1992 | / | ZCFD407820 9014566 | Defekt | Automjet ushtarak | Motorri defekt problem me ndezjen, servisim periodik dhe 2 bateri 110 Ah. | | ✓ | Aktualisht nuk perdoret nga AGJ | |
| 8 | P.G.S / Pirunier Elektrikë | Universal / W1814 | M.TH 142 | Speicale | 17,542 | 1989 | 4370 | ET,3000,S, | Defekt | Pirunier bateri | Pirunieri është Elektrik dhe ka gjithsejt 40 bateri të lidhura në seri ku të gjitha janë jashtë funksionit. | | ✓ | Aktualisht nuk perdoret nga AGJ | |
| 9 | FIAT Ducato / Kombibus | 230BLM Q824T | M.TH 015 | Lehtë | 10,776 | 2000 | 1400 | ZFA230000* 05949134 | O.K | Mini Bus 8+1 Ulese | Gjendja e mirë përveq servisimit periodik dhe 1 bateri 100 Ah. | | ✓ | Aktualisht nuk perdoret nga AGJ | |
| 10 | FIAT A.C.M 90 Borepastrues | ACM 90PM16 | M.TH 018 | Rëndë | 41,820 | / | 4700 | ZCFB90BS00 9007343 | O.K | KamionBorepastrues | | | ✓ | Aktualisht nuk perdoret nga AGJ | |
| 11 | Pastrues bore | n/a | M.TH 145 | | | / | / | 26628/31WQ | O.K | Makine dore me benzin per pastrim te stazave per kembesor | Gjendja e mire përveq servisimit periodik dhe mungeses se rrypave te maqines | | ✓ | Aktualisht nuk perdoret nga AGJ. | |
| INVENTARI (të përfshira në kërkesën paraprake të KRU Gjakova) - dhe të dërguara në MZHE përmes përgjigjes nga AGJ dt.31.07.2018. | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | VENTIL F/F | 2" | M.H 749 | | 229 | / | / | / | O.K | 9 COP | Gjendja e mire | | ✓ | Aktualisht nuk perdoret nga AGJ. | Nga lista paraprake |
| SHENIM: KRU "Gjakova" Sh.A ka hequr dorë nga kërkesa fillestare për autobus të madh (38+1 ulëse), andaj I njëjti është larguar nga kjo listë së bashku me 6 gomat e kërkuara paraprakisht (meqë ishin të autobusit në fjalë) | | | | | | | | | | | | | | | |

LISTA E MAKINERISE DHE MJETEVE TE PUNES REFERUAR KERKESES SE KRU "GJAKOVA" SH.A - listat përfshijnë vetëm paisjet që aktualisht nuk përdoren nga NPQ "Aeroporti i Gjakoves" Sh.A.

| Nr. | Marka / Lloji / Tipi i Makines | Tipi | Lloji i inventarizimit | Kategoria / Tonazhi | Vlera në EURO | Viti i Prodhimit | Pesha kg | Nr. Shasisë | Gjendja aktuale | Përshkrimi | Komenti | Ne perdorim nga AGJ | Aktualisht nuk perdoret nga AGJ | Shpjegime | Sqarim i listave |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| GJENERATORE AVIONESH (të përfshira në kërkesën paraprake të KRU Gjakova) - dhe të dërguara në MZHE përmes përgjigjes nga AGJ dt.31.07.2018 | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | Generator / Pneumatik | | M.TH 030 | Speicale | 99,184 | / | 4450 | / | O.K | Per mbushje me ajer te avionit | Gjendja e mirë përveq servisimit periodik dhe 2 baterive 75 Ah. | | ✓ | Gjenerator per furnizim me ajer (me presion te caktuar) gjate ndezjes se avioneve (ndezjen e avioneve te paisur me motor pneumatik). Meqe AGJ nuk operon aktualisht si aeroport edhe nuk eshte ne perdorim. | Gjeneratorët që aktualisht nuk përdoren nga AGJ të cilat janë të përfshira në listën paraprake dorëzuar në MZHE dt. 31.07.2018 meqë kanë qenë tkërkuara nga KRU "Gjakova". |
| 2 | DEUTZ / Generator | | M.TH 035 | Speicale | 21,747 | / | 4450 | / | O.K | Per mbajtje ndezur avionin | Gjendja e mirë përveq servisimit periodik dhe 2 baterive 155 Ah. | | ✓ | Gjenerator rryme per mbjatjen ndezur te avionit gjate parkingut deri ne kompletim te puneve tokesore (complete boarding, exit passengers, parking, etc). Meqe AGJ nuk operon aktualisht si aeroport edhe nuk eshte ne perdorim. | |
| 3 | DEUTZ / Generator | | M.TH 034 | Speicale | 21,747 | / | 4450 | / | O.K | Per mbajtje ndezur avionin | Gjendja e mirë përveq servisimit periodik dhe 2 baterive 75 Ah. | | ✓ | Gjenerator rryme per mbjatjen ndezur te avionit gjate parkingut deri ne kompletim te puneve tokesore (complete boarding, exit passengers, parking, etc). Meqe AGJ nuk operon aktualisht si aeroport edhe nuk eshte ne perdorim. | |

| GJITHSEJT: € 679,497 | | |
|---|---|---|
| Automjete 10 cop në vlerë monetare (sipas donacionit nga KFOR It) | € | 536,168 |
| Inventar: 9 ventila uji dhe 1 karikues baterie në vlerë monetare (sipas donacionit nga KFOR It) | € | 651 |
| Gjeneratorë: 1 pneumatik dhe 2 elektrik në vlerë monetare (sipas donacionit nga KFOR It) | € | 142,678 |

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 08/65**
**Datë: 13.09.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke iu referuar kërkesës së Ministrisë së Punëve të Brendshme, me nr. protokoli 642, datë 10.09.2018, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme për përjashtim nga fushëveprimi i Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, për Projektin "Ngritja e Sigurisë Kibernetike".

2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 09/65**
**Datë: 13.09.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke shyqrtuar propozimin e Ministrisë së Infrastrukturës, me nr. protokoli 8366, datë 04.09.2018, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet DHËNIA e PËLQIMIT për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror – AShNA, që të vazhdoj punimet për vendosjen e kabllos optike nga Objekti i i AShNA-së në drejtim të Goleshit (vendëndodhja e radarit) nëpër ngastrat me Nr. 00286, 09020, 09021 dhe 09016, në Zonën Kadastrale Vrellë e Goleshit-Lipjan, të cilat momentalisht janë në shfrytëzim nga Njësia Speciale e Policisë së Kosovës.

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 10/65**
**Datë: 13.09.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 12 të Ligjit Nr. 04/L-144 Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator 2018, nxjerr këtë:

# V E N D I M

1. Aprovohet Propozimi i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për kërkesën e Komunës së Prizrenit për tërheqjen nga procesi i privatizimit pronat e O.P e Pylltarisë "Sharri" të cilat aktualisht janë nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, dhe kthimin e tyre në pronësi të komunës me qëllim të realizimit të interesit publik në komunën e Prizrenit.

2. Zonat Kadastrale të cilat janë objekt i këtij vendimi janë: ngastrat me nr. 02521-0 ZK Vërmicë, me sipërfaqe prej 6411 m2 dhe ngastrat kadastrale me nr. 02522-0 ZK Vërmicë, me sipërfaqe prej 10725 m2.

3. Kompensimet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit në shumën prej njëzet për qind (20%) të vlerës së pronës sipas vlerësimit, për të kompensuar punëtorët e kualifikuar të Ndërmarrjes Shoqërore, si dhe kërkesat e kreditorëve nga procesi i likuidimit deri në shumën e përgjithshme të vlerësimit, do të bëhet sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

4. Prona nga pika 2. e këtij vendimi, nuk mund të shfrytëzohet për qëllime të tjera, përveç destinimit të përcaktuar.

5. Obligohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal që të zhvillojë procedurat e mëtejme me Agjencionin Kosovar të Privatizimit, deri në vendimin përfundimtar për bartje të pronës.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 11/65**
**Datë: 13.09.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 12 të Ligjit Nr. 04/L-144 Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Propozimi i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për kërkesën e Komunës së Istogut për tërheqjen nga procesi i privatizimit dhe kthimin në pronësi të komunës me qëllim të realizimit të interesit publik për realizimin e projektit për ndërtimin e sheshit dhe hapësirë për interes të qytetarëve.

2. Zonat Kadastrale të cilat janë objekt i këtij vendimi janë zonat kadastrale të përcaktuara me Nr. të parcelave UL-70806020-000830 me sipërfaqe prej 0.90.52 ha, dhe parcela me Nr. UL-70806020-000827 me sipërfaqe prej 0.76.97 ha.

3. Kompensimet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit në shumën prej njëzet për qind (20%) të vlerës së pronës sipas vlerësimit, për të kompensuar punëtorët e kualifikuar të Ndërmarrjes Shoqërore, si dhe kërkesat e kreditorëve nga procesi i likuidimit deri në shumën e përgjithshme të vlerësimit, do të bëhet sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

4. Prona nga pika 2. e këtij vendimi, nuk mund të shfrytëzohet për qëllime të tjera, përveç destinimit të përcaktuar.

5. Obligohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal që të zhvillojë procedurat e mëtejme me Agjencionin Kosovar të Privatizimit, deri në vendimin përfundimtar për bartje të pronës.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeminister i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 12/65**
**Datë: 13.09.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 8, 44 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator 2018, nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet shqyrtimi i mëtejmë i kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga themelimi i Zonës Ekonomike në Komunën e Malishevës, Zonat Kadastrale Banjë, Bellanicë dhe Senik të Komunës së Malishevës, sipas tabelave të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, konform Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ nr.02/2015 ''Për zbatimin e metodave dhe kritereve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin''.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe Ministria e Financave.

4. Mjetet financiare për kompensimin e pronave, shpenzimet e procedurës të shpronësimit dhe vlerësimit do të sigurohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 13/65**
**Datë: 13.09.2018**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 shtator 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Rregullorja për Gradat dhe Pagat e Krijuesve dhe Performuesëve të Kulturës dhe Punonjësve Profesionalë të Trashëgimisë Kulturore.

2. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë